

VENDIM
Nr.60, datë 27.9.2006

**PËR MOSMIRATIMIN E OBJEKTIT TË KËRKESËS SË 35 DEPUTETËVE PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR “PËR VERIFIKIMIN E
LIDHJEVE NEPOTIKE, KONFLIKTIN E INTERESIT DHE PËRFITIMEVE PASURORE
QË RRJEDHIN PREJ TYRE PËR KRYEMINISTRIN SALI BERISHA, FAMILJARËT DHE
TË AFËRMIT E TIJ”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe në bazë të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kërkesës së 35 deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për objektin “Për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin Sali Berisha, familjarët dhe të afërmit e tij” për shkak se objekti i kërkesës së mësipërme është i njëjtë, tërësisht i ezauruar, me objektin e vendimit të Kuvendit nr.59, datë 18.9.2006 “Për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)